



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
SEKTORI JURIDIK

URDHËR

Nr. 2, datë 14.02.2018

MBI

**“NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR PRANIMIN E APLIKIMEVE
TË STUDENTËVE, TË CILËT PËRJASHTOHEM NGA TARIFA VJETORE
E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018,
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” dhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Arsimit nr. 27, datë 29.12.2017 për “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë,

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit të punës për pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2017-2018, në Universitetin e Arteve (UART), me përbërje si më poshtë:
 - Elia Plaku
 - Ted Kamberi
 - Jeta Shashaj
2. Grupi i punës ka për detyrë të pranojë dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (formulari bashkangjitur), publikuar në Web-in e UART;
3. Studentët duhet ti dorëzojnë aplikimet/formularin, pranë Zyrës së Protokollit të UART;
4. Afati i dorëzimit të aplikimeve nga ana e studentëve është deri në datën **1 Mars 2018**;
5. Zyra e protokollit i regjistron aplikimet e studentëve në një regjistër të veçantë;
6. Grupi i punës pasi grumbullon dokumentacionin e paraqitur nga studentët, i përgatit informacionin Administratorit të Universitetit të Arteve (UART), për Miratim në Bordin e Administrimit.

Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
SEKTORI JURIDIK



7. Në çdo rast, kur një student aplikant paraqet dokumentacion/formularin për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2017 - 2018, që në të ardhmen rezultojnë jo ligjorë, përgjegjësia bije mbi studentin i cili do të penalizohet.
8. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Web-it, të Universitetit të Arteve.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, zyra e protokollit e UART, anëtarët e grupit të punës dhe sekretaritetë e Fakulteteve për njoftimin dhe shpalljen e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Prof. Kastriot ÇAUSHI



REKTORI
UNIVERSITETI I ARTEVE

- * Elia Plaku
- * Ted Karberi
- * Jeta Shashaj